

STATISTIKAT E SEKTORIT TË JASHTËM

PËRKUFIZIME

I. TË PËRGJITHSHME


Rezidentë janë:

- a) shoqëritë tregtare dhe personat e tjerë juridikë me zyrë qendrore në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke përjashtuar degët e tyre me seli jashtë territorit të Shqipërisë;
- b) degët e shoqërive të huaja të regjistruara në Republikën e Shqipërisë në përputhje me ligjin nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij;
- c) dega e bankës së huaj e licencuar nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari bankare dhe/ose financiare në Republikën e Shqipërisë sipas ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi;
- d) personat fizikë tregtarë, që në mënyrë të pavarur ushtrojnë një aktivitet tregtar si punësim parësor dhe që kanë qendrën e ushtrimit të aktivitetit dhe/ose vendbanimin e tyre në Republikën e Shqipërisë;
- e) personat fizikë, të cilët kanë vendbanimin e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, në kuptim të nenit 12 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë;
- f) personat fizikë/shtetasit e huaj, të cilët kanë vendqëndrimin në Republikën e Shqipërisë, në kuptim të nenit 14 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, dhe të cilët disponojnë në mënyrë të vazhdueshme lejen e qëndrimit në Republikën e Shqipërisë në përputhje me ligjin nr. 9959, datë 17.07.2008 "Për të huajt";
- g) diplomati ose punonjësi shqiptar së bashku me familjarët e tij, të caktuar me punë nga shteti shqiptar në ambasadë, konsullatë apo në organizma ndërkombëtare jashtë shtetit, të cilët nuk kryejnë ndonjë aktivitet ekonomik apo tregtar;

Të gjithë personat e tjerë, të cilët nuk përfshihen në përcaktimet e mësipërme do të konsiderohen si "jorezidentë".

II. SEKTORËT INSTITUCIONALE NË STATISTIKAT E SEKTORIT TË JASHTËM

Korporatat jofinanciare (S.11) përfshijnë njësi institucionale, të cilat janë subjekte juridike të pavarura, dhe prodhues tregu, aktiviteti kryesor i të cilëve është prodhimi i mallrave dhe shërbimeve jofinanciare. Në Shqipëri, në nënsektorin e korporatave jofinanciare klasifikohen të gjitha shoqëritë tregtare jofinanciare, të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Përjashtim bëjnë vetëm personat fizikë, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me nenin 2 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe që klasifikohen në sektorin "Individët" (Ekonomitë familjare).



Sektori i korporatave financiare (S.12) - përbëhet prej njërive institucionale, të cilat janë persona juridikë të pavarur, prodhues tregu, aktiviteti kryesor i të cilave është prodhimi i shërbimeve financiare. Njësi të tilla institucionale përfshijnë të gjitha korporatat dhe thujtse - korporatat, të cilat janë kryesisht të angazhuara në: a) ndërmjetësim financiar, dhe/ose b) aktivitete financiare ndihmëse. Korporatat financiare (S.12) përfshijnë këta nënsektorë:

- **Banka qendrore (S.121)** - ka si funksion kryesor të saj të emetojë monedhën, të ruajë vlerën e brendshme dhe të jashtme të monedhës, si dhe të mbajë të gjitha ose një pjesë të rezervave ndërkombëtare të vendit. Banka qendrore e Shqipërisë është Banka e Shqipërisë.
- **Korporatat e tjera depozituese (S.122)**, të cilat përfshijnë të gjitha korporatat financiare dhe thujtse korporatat të angazhuara kryesisht në ndërmjetësim financiar, kanë si aktivitet kryesor të pranojnë depozita, të japin kredi dhe të bëjnë investime në letra me vlerë. Në Shqipëri, ky nënsektor formohet nga bankat tregtare dhe shoqëritë e kursim-kreditit.
- **Fondet e investimeve të tregut të parasë (S.123)** - të cilat njihen edhe si fonde të përbashkëta ose institucione për investim kolektiv përfshin të gjitha skemat e investimeve kolektive të angazhuara në ndërmjetësim financiar. Aktiviteti i tyre është të emetojë aksione dhe kuota të fondeve të investimit, të cilat janë zëvendësues të afërt të depozitave dhe bëjnë investime në mjete financiare afatshkurtra.
- **Fondet e investimit (S.124)** - të cilat njihen edhe si fonde të përbashkëta ose institucione për investim kolektiv përfshin të gjitha skemat e investimeve kolektive të angazhuara në ndërmjetësim financiar. Aktiviteti i tyre është të emetojnë aksione dhe kuota të fondeve të investimit, të cilat nuk janë zëvendësues të afërt të depozitave dhe bëjnë investime në aktive financiare kryesisht afatgjata dhe në aktive jofinanciare (zakonisht në pasuri të patundshme). Në Shqipëri, këto institucione operojnë në përputhje me ligjin nr.10 198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive".
- **Ndërmjetës të tjerë financiarë (S.125)** – (përveç shoqërive të sigurimit dhe fondeve të pensionit vullnetar) – përfshihen të gjitha institucionet e tjera që kryejnë ndërmjetësim financiar (përfshijë kompanitë e sigurimit dhe fondet e pensionit) të tillë si: institucionet e kreditit, institucionet që ofrojnë qiranë financiare (leasing), institucionet e financimit të transaksioneve tregtare, institucionet e mikrokredisë, faktoringut, unionet e shoqërive të kursim-kreditit etj.
- **Ndihmësit financiarë (S.126)** – përfshihen të gjitha institucionet që lehtësojnë ndërmjetësimin financiar, të tilla si: institucionet e transferimit të parave dhe të gjitha shërbimet e pagesave, shoqëritë administruese të fondeve të investimit dhe të fondeve të pensionit vullnetar, zyrat e këmbimit valutor etj.
- **Kompanitë e financimit të kontrolluara nga kompani të tjera dhe huadhënësit e parave (S.127)** - përfshijnë njësitë ekonomike të krijuara për një qëllim të veçantë (SPE - special purpose entity), kompanitë holding, trustet etj.
- **Kompanitë e sigurimit (S.128)** - ofrojnë shërbimet e sigurimit të jetës dhe jojetës për individë dhe kompani, si edhe risigurimin e kompanive të tjera të sigurimit.



- **Fondet e pensionit (S.129)** - përfshijnë të gjitha kompanitë, të cilat janë të angazhuara kryesisht në ndërmjetësim financiar si pasojë e grupimit të rreziqeve sociale dhe të nevojave të personave të siguruar. Këto janë fonde vullnetare, të cilat, ashtu si skema e sigurimeve shoqërore, sigurojnë të ardhura pas daljes në pension dhe përfitime në raste paafësie dhe vdekjeje.

Qeveria e përgjithshme (S.13) përfshin ato njësi institucionale, të cilat janë prodhues jotregu ose kanë funksion kryesor rishpërndarjen e të ardhurave dhe pasurisë kombëtare dhe në më shumë se 50% të aktivitetit financohen nga buxheti i qeverisë. Në Shqipëri, sektori i qeverisë së përgjithshme përbëhet nga tre nënsektore: qeveria qendrore (S.1311), qeveria lokale (S.1313) dhe fondet e sigurimeve shoqërore (S.1314). Përveç institucioneve buxhetore, sektori publik bazuar në ESA 2010 përfshin edhe ndërmarrjet, të cilat janë nën varësi ose kontrollohen nga qeveria. Lista e plotë e njërive institucionale të klasifikuara në sektorin e qeverisë së përgjithshme është e publikuar në faqen e internetit të INSTAT-it.

- **Qeveria qendrore (S.131)** - përfshin të gjitha departamentet administrative të shtetit dhe agjencitë qendrore kompetencat e të cilave shtrihen mbi gjithë territorin ekonomik të vendit. Të tilla janë ministritë dhe administrata publike qendrore, organizatat jo me qëllim fitimi të kontrolluara nga qeveria etj.
- **Qeveria lokale (S.1313)** – konsiston në të gjitha llojet e administratës publike, e cila mbulon përgjegjësitë e saj vetëm brenda territorit ekonomik lokal, (pa përfshirë agjencitë lokale të fondeve të sigurimeve shoqërore). Të përfshira në këtë nënsektor janë gjithashtu ato institucione jofitimprurëse, të cilat janë të kontrolluara nga pushteti vendor dhe që ushtrojnë aktivitetin e tyre vetëm brenda territorit ekonomik të qeverisë lokale.
- **Fondet e sigurimeve shoqërore (S.1314)** – përfshijnë njësitë institucionale qendrore dhe lokale aktiviteti kryesor i të cilave është të sigurojnë përfitime sociale. Në Shqipëri, në këtë nënsektor klasifikohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH) dhe Fondi i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor.

Ekonomitë familjare (S.14) përbëhen nga individë dhe grupe individësh, të cilët janë kryesisht konsumatorë, ndajnë të njëjtën banesë dhe të ardhura të përbashkëta dhe konsumojnë kolektivisht mallrat dhe shërbimet. Përfshihen, gjithashtu, individë ose grupe individësh, të cilët janë të angazhuar në aktivitet ekonomik, për shitje në treg ose për konsumin e vetë ekonomisë familjare. Në këtë sektor përfshihen personat fizikë (tregtarët), të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me nenin 2 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Institucionet jo me qëllim fitimi në shërbim të individëve (S.15) - përbëhen nga institucionet jo me qëllim fitimi, të cilat janë njësi ligjore të pavarura, u shërbejnë ekonomive familjare dhe nuk prodhojnë për tregun. Institucione të tilla i sigurojnë ekonomive familjare mallra dhe shërbime falas, ose me çmime që nuk janë ekonomikisht domethënëse. Të tilla janë sindikatat, shoqatat e konsumatorëve, partitë politike, kishat, shoqëritë fetare, organizatat bamirëse etj.



III. BILANCI I PAGESAVE, POZICIONI I INVESTIMEVE NDËRKOMBËTARE DHE BORXHI I JASHTËM

Bilanci i pagesave është një pasqyrë statistikore që përmbledh në mënyrë sistematike, transaksionet ekonomike dhe financiare të një ekonomie me pjesën tjetër të botës, për një periudhë të caktuar kohe. Flukset ekonomike dhe financiare përfaqësojnë transaksione që regjistrohen në llogarinë korrente, llogarinë kapitale dhe financiare.

Në **kredi** regjistrohen eksporti i mallrave, shërbimeve dhe të ardhurave të arkëtueshme.

Në **debi** regjistrohen importi i mallrave, shërbimeve dhe të ardhurave të pagueshme.

Llogaria korrente regjistron flukset e mallrave, shërbimeve dhe të ardhurave parësore dhe dytësore midis Shqipërisë dhe pjesës tjetër të botës.

Llogaria e mallrave përfshin transaksionet në mallra, pronësia e të cilave kalon nga rezidentët tek jorezidentët dhe anasjelltas.

Mallrat e përgjithshme mbulojnë transaksionet e mallrave, pronësia e të cilave kalon nga rezidentët te jorezidentët dhe anasjelltas, duke përjashtuar mallrat nën ndërmjetësim tregtar, arin jomonetar, mallra të blera gjatë udhëtimeve, mallra të blera për shërbime konstruksioni, mallrat dhe shërbime qeveritare. Mallra nën ndërmjetësim tregtar përfshijnë transaksionet që lidhen me blerjen e mallrave të huaja nga rezidentët dhe rishitjen e tyre tek jorezidentët, kur mallrat nuk e kalojnë kufirin, pra nuk importohen në territorin e Shqipërisë; dhe blerjen e mallrave shqiptare nga rezidentët dhe rishitjen e tyre te jorezidentët, pa dalë nga territori i Shqipërisë.


Ari jomonetar mbulon të gjithë arin përveç arit monetar. Ari monetar zotërohet nga bankat qendrore dhe mbahet si mjet rezerve.

Llogaria e shërbimeve përfshin të gjitha shërbimet që rezidentët e Shqipërisë u kryejnë jorezidentëve dhe anasjelltas.

Shërbimet për përpunim të inputeve fizike të zotëruara nga të tjerët përfshijnë shërbime si përpunimi, paketimi, grumbullimi, etiketimi i mallrave të kryera nga ndërmarrjet të cilat nuk i zotërojnë vetë këto mallra, por paguhen nga zotëruesit e mallrave për shërbimin e mundësuar. Përjashtohen montimi i mallrave për ndërtim, i cili klasifikohet nën shërbime konstruksioni, si dhe etiketimi dhe paketimi që lidhet me transportin, i cili klasifikohet nën shërbime transporti.

Shërbime mirëmbajtjeje dhe riparimi përfshin shërbimin e kryer për riparimin dhe mirëmbajtjen e makinerive, pajisjeve të transportit dhe mallrave të tjera. Këtu përfshihet çdo pjesë ose material i furnizuar nga riparuesi dhe i përfshirë në pagesë. Pjesët dhe materialet e përfshira regjistrohen në llogarinë e mallrave. Përjashtohen pastrimi i pajisjeve të transportit që përfshihen në shërbime transporti; mirëmbajtja dhe riparimi i ndërtimeve që regjistrohet në shërbime konstruksioni; mirëmbajtja dhe riparimi i kompjuterëve që regjistrohen në shërbime telekomunikacioni, kompjuteri dhe informacioni.

Shërbime transporti përfshijnë transportin e pasagjerëve dhe mallrave nga një vend në një tjetër



dhe shërbimet mbështetëse dhe ndihmëse që lidhen me transportin. Transporti përfshin transportin e pasagjerëve, mallrave dhe shërbimeve të tjera transporti sipas mënyrës së transportit (detar, ajror, hekurudhor, rrugor dhe transporte të tjera). Gjithashtu, përfshihen shërbimet postare dhe korrieri, transporti me tubacion dhe transmetimi i energjisë elektrike.

Shërbimet e transportit të udhëtarëve përfshijnë transportin ndërkombëtar të jorezidentëve nga transportuesit rezidentë (që regjistrohet si eksport) dhe transportin e rezidentëve nga transportuesit jorezidentë (që regjistrohet si import). Gjithashtu, përfshihet transporti lokal i ofruar për rezidentët nga transportues jorezidentë. Transporti i udhëtarëve paraqitet sipas mënyrave kryesore të transportit: detar, ajror, hekurudhor, rrugor dhe të tjera.

Shërbimet e transportit të mallrave përfshijnë transportin e mallrave, i cili paraqitet sipas mënyrave kryesore të transportit: detar, ajror, hekurudhor, rrugor dhe të tjera.

Shërbime të tjera transporti përfshijnë transportimin e mallrave, magazinimin, paketimin dhe ripaketimin, shërbimet e lundrimit, kontrollin e trafikut ajror, pastrimin e pajisjeve të transportit, operacionet e rikuperimit, tarifat e agjentëve të lidhura me transportin e udhëtarëve dhe mallrave, tarifat për udhëtime dhe rezervime etj. Këtu përjashtohen sigurimi i mallrave, i cili përfshihet në shërbimet e sigurimeve; karburantet, mallrat dhe furnizimet e blera në porte dhe aeroporte nga transportues jorezidentë (Mallra); mirëmbajtja dhe riparimi i pajisjeve të transportit (Shërbime mirëmbajtjeje dhe riparimi); riparimet e hekurudhave, ndërtesave në porte dhe aeroporte (Shërbime konstruksioni); dhe dhënia me qira e pajisjeve të transportit pa staf (lizingu operacional). Këto shërbime paraqiten sipas mënyrave kryesore të transportit: detar, ajror, hekurudhor, rrugor dhe të tjera.

Transporti me tubacion është transporti ndërkombëtar me tubacion i naftës dhe i produkteve të ngjashme, ujit dhe gazit. Përjashtohen shërbimet e shpërndarjes nga nënstacionet tek konsumatori (Shërbime të tjera biznesi) dhe vlera e produkteve të transportuara (Mallra).

Transmetimi i energjisë elektrike nënkupton transmetimin ndërkombëtar të energjisë elektrike nga linjat e tensionit të lartë. Kjo përfshin tarifat për transmetimin e energjisë elektrike nëse ato do të mund të dalloheshin nga kostoja e prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike; përjashtohet kostoja e energjisë së transmetuar (Mallra) dhe shërbimet e shpërndarjes te konsumatori (Shërbime të tjera biznesi).

Shërbime të tjera mbështetëse dhe ndihmëse të transportit përfshijnë shërbimet që ndihmojnë transportin dhe nuk lidhen drejtpërsëdrejti me lëvizjen e mallrave dhe njerëzve. Kjo mbulon vetëm transportin mbështetës dhe shërbimet ndihmëse, të cilat nuk mund të ndahen ndërmjet mënyrave kryesore të transportit (det, ajër, hekurudhë, rrugë dhe të tjera).

Shërbime postare dhe korrieri përfshijnë marrjen, transportin dhe shpërndarjen e letrave, gazetave, periodikëve, materialeve të tjera të shtypura, broshurave dhe pakove, duke përfshirë pullat e zyrave postare dhe shërbimet lidhur me kutitë postare të marra me qira.

Shërbimet e udhëtimeve përfshijnë mallrat dhe shërbimet e përfituara, nga një person që udhëton jashtë vendit, për përdorim vetjak ose në formën e dhuratave. Gjithashtu këtu përfshihet edhe transporti lokal. Përjashtohet transporti ndërkombëtar (transporti i udhëtarëve), mallrat e blera për t'u rishitur dhe mallra të tjera të çmueshme si bizhuteri, vepra arti apo mjete transporti (mallra).



Udhëtime për qëllime biznesi mbulojnë blerjen e mallrave dhe shërbimeve nga udhëtarët për qëllime biznesi. Gjithashtu, përfshihet blerja e mallrave dhe shërbimeve nga punëtorët sezonalë, ndërkufitarë dhe të tjerë të cilët nuk janë rezidentë të ekonomisë ku janë punësuar.

- **Punonjësit ndërkufitarë** janë ata punonjës, rezidenca e përhershme e të cilëve është në një ekonomi, por që punojnë në një ekonomi tjetër, zakonisht të një vendi fqinj.
- **Punonjësit afatshkurtër ose ndryshe sezonalë**, janë punonjësit të cilët punojnë në një ekonomi tjetër për më pak se një vit.

Udhëtime për qëllime personale përfshijnë mallrat dhe shërbimet e përvetësuara nga udhëtarë të cilët udhëtojnë jashtë vendit për çdo qëllim tjetër, si pushime, vizita të afërmit, për edukim apo trajtim shëndetësor.

Shërbimet e konstruksionit mbulojnë kostot e aktiviteteve ndërtuese, jashtë vendit nga kompanitë rezidente ose aktivitete ndërtuese në Shqipëri nga kompani jorezidente. Këtu përfshihen gjithashtu mallrat dhe shërbimet e blera në vendin ku kryhet ndërtimi, për qëllime konstruksioni. Kontratat ndërkombëtare ndërtuese janë zakonisht afatshkurtra. Për projekte afatgjata të një shkalle të gjerë në një vend të huaj, kjo kompani kthehet në kompani investimesh direkte në atë vend dhe konsiderohet një projekt rezident.

Shërbimet e sigurimit dhe të pensioneve mbulojnë pagesat për shërbimet e sigurimit direkt dhe risigurimit. Gjithashtu, përfshihen shërbimet ndihmëse të sigurimit dhe shërbimet e fondit të pensionit.

Sigurimi direkt mbulon sigurimin e jetës dhe jojetës (duke përfshirë sigurimin e mallrave). Sigurimi direkt ndodh kur një sigurveues siguron kompaninë, individët dhe njësitë e tjera institucionale ndaj rrezikut. Shërbimet e sigurimeve direkte mbulojnë diferencën midis primeve të sigurimit me të ardhurat e fituara nga ato dhe dëmet e pagueshme.


Risigurimi është sigurim ku të dyja palët e policës janë ofrues shërbimesh sigurimesh. Risigurimi lejon që rreziku i sigurimit të transferohet pjesërisht nga njëri sigurveues te tjetri.

Shërbime ndihmëse të sigurimit mbulojnë shërbimet të cilat lidhen ngushtë me aktivitetet e sigurimi, si komisionet e agjentëve, shërbime këshillimi, shërbime vlerësimi, aktuale, rregulluese dhe monitoruese.

Shërbimet financiare mbulojnë shërbimet e ndërmjetësimit financiar dhe shërbimet ndihmëse, duke përfshirë shërbimet e sigurimit dhe fondit të pensioneve, komisionet dhe tarifatat që lidhen me ndërmjetësimin financiar, letrat me vlerë, depozita, hua, konsulencën financiare dhe të tjera të ngjashme.

Shërbimet financiare direkte mbulojnë shërbimet financiare për të cilat paguhet një tarifë për ofrimin e shërbimeve, siç janë tarifatat e kontratës për marrjen e një kredie ose tarifatat për mirëmbajtjen e kartave bankare.

Shërbimet e ndërmjetësimit financiar të matura indirekt (FISIM) janë shërbimet që ofrojnë ndërmjetësit financiarë. Ndërmjetësuesit financiarë paguajnë për këto shërbime nëpërmjet një marzhi të normës së interesit për depozitat dhe kreditë e klientëve.



Pagesa për përdorimin e pasurisë intelektuale mbulojnë:

1. tarifat për përdorimin e të drejtave të pronësisë (patentat, markat tregtare, e drejta e autorit, teknologjitë dhe dizenjet industriale, duke përfshirë sekretet tregtare dhe franshizat); këto të drejta mund të krijohen nga kërkim-zhvillimi ose marketingu;
2. tarifat mbi licencat për riprodhimin dhe shpërndarjen e origjinaleve ose prototipeve (të drejtat e autorit mbi librat dhe dorëshkrimet, programet kompjuterike, veprat kinematografike dhe regjistrimet audio) dhe të drejtat e lidhura me to (shfaqje në transmetim të drejtpërdrejtë, televizion, transmetim kabllor ose satelitor).

Shërbime telekomunikacioni, kompjuteri dhe informacioni mbulojnë transmetimin e të dhënave me anë të mjeteve elektronike (telefon, radio, televizion ose internet) dhe gjithashtu mbulojnë shërbime të lidhura me pajisjet hardware dhe software, agjencitë e lajmeve dhe bazat e të dhënave.

Shërbimet e telekomunikacionit mbulojnë transmetimin audio dhe video apo informacione të tjera duke përdorur pajisjet e telekomunikacionit, duke përjashtuar koston e informacionit që transmetohet. Kjo mbulon gjithashtu shërbimet e telekomunikacionit celular dhe tarifat e aksesit për shërbimet e internetit. Përjashtohen shërbimet e instalimit për pajisjet e rrejtit telefonik (shërbime konstruksioni) dhe shërbimet e bazës së të dhënave (shërbimet e informacionit).

Shërbimet kompjuterike mbulojnë shërbimet që lidhen me kompjutera dhe sisteme programesh, shërbimet e përpunimit të të dhënave (konsulencë, riparim dhe mirëmbajtje, shërbime të rimëkëmbjes së dëmeve, licenca për përdorimin e programeve jo të personalizuar, zhvillim të programeve të personalizuar, dizajnim të faqeve të internetit dhe të ngjashme. Përjashtohen tarifat për licencat për riprodhimin ose shpërndarjen e programeve (Pagesa për përdorimin e pasurisë intelektuale) dhe programet e papersonalizuara të siguruara fizikisht (CD, USB, etj.) me të drejtën për përdorim të përhershëm (Mallra).

Shërbimet e informacionit janë shërbime të agjencive të lajmeve, shërbime të bazës së të dhënave (konceptimi i bazës së të dhënave, portalet e kërkimit të internetit dhe motorët e kërkimit), dhe abonimet e drejtpërdrejta të periodikëve (gazetat dhe revistat në formë fizike regjistrohen në llogarinë e mallrave).

Shërbime të tjera biznesi përfshijnë shërbimet e konsulencës profesionale dhe të menaxhimit, shërbime teknike, shërbime të lidhura me tregtinë dhe shërbime të tjera biznesi.

Shërbime të kërkimit dhe zhvillimit mbulojnë shërbimet e lidhura me kërkimin bazë, kërkimin e avancuar dhe zhvillime eksperimentale të produkteve dhe proceseve të reja; shitje e plotë e rezultateve të kërkim-zhvillimit (patentat, të drejtat e autorit ose proceset industriale). Ndërsa të drejtat për përdorimin e produkteve të kërkim-zhvillimit regjistrohen nën "Pagesa për përdorimin e pasurisë intelektuale" (e përmendur më lart). Gjithashtu, përfshihen kërkimet komerciale në lidhje me elektronikën, farmaceutikën dhe bioteknologjinë, si dhe blerjen ose shitjen e të drejtave të pronësisë që rrjedhin nga kërkimet dhe zhvillimet (patentat, të drejtat e autorit që rrjedhin nga kërkimet dhe zhvillimet, dhe dizenjet industriale, duke përfshirë sekretet tregtare).



Shërbimet e konsulencës profesionale dhe të menaxhimit mbulojnë shërbimet ligjore, kontabiliteti, konsulencë menaxhimi, shërbime menaxheriale dhe shërbime të marrëdhënieve me publikun.

Shërbime teknike, të lidhura me tregtinë dhe shërbime të tjera biznesi përfshijnë shërbime arkitekturore, inxhinierike dhe shërbime të tjera teknike, shërbime të lidhura me tregtinë (komisionet për transaksionet e mallrave dhe shërbimeve që u paguhen tregtarëve, agjentëve të mallrave, komisionerëve dhe ndërmjetësuesit), trajtimi dhe pastrimi i mbetjeve, shërbime bujqësore dhe minierave, shërbimet e bujqësisë dhe të minierave, dhe operacionet e lizingut. Operacionet e lizingut përfshijnë marrjen me qira të aktiveve të prodhuara (ndërtesa, pajisje ose mjete transporti pa ekuipazh) pa transferim të pronësisë dhe rreziqe ndaj qiramarrësit. Këto kontrata zakonisht kanë një afat më të shkurtër se dy vjet.

Shërbime personale, kulturore dhe argëtimi përfshijnë shërbime shëndetësore dhe edukimi të siguruara nëpërmjet internetit ose lokalisht. Gjithashtu, përfshihen shërbime kulturore dhe argëtimi të lidhura me aktivitete kulturore, sportive, lojëra fati dhe argëtuese. Përfshihen të tilla shërbime që përfitohen gjatë një udhëtimi (udhëtime).

Shërbime dhe mallra qeveritare përfshijnë:

1. mallra dhe shërbime që sigurohen nga ambasadat dhe bazat ushtarake të huaja të vendosura në Shqipëri dhe anasjelltas;
2. shpenzimet e diplomatëve, stafit të konsullatave, personelit ushtarak në vendet ku janë të vendosura lokalisht;
3. shërbime që ofrohen nga/për njësitë qeveritare, të cilat nuk përfshihen në të tjera kategori shërbimesh.

Të ardhura parësore janë të ardhura të përfituara si rezultat i kontributit të fuqisë punëtore në procesin e prodhimit (të ardhura nga puna, taksa mbi produktet dhe prodhimin, subvencionet), si dhe nga sigurimi i burimeve financiare dhe natyrore (të ardhura nga investimet).

Të ardhura nga puna përfshin kompensimin në pagë bruto të punonjësve rezidentë (duke përfshirë tatimin dhe kontributet shoqërore) për një kontratë pune deri në një vit, jashtë rezidencës së tyre.


Të ardhurat nga investimet përfshijnë të ardhurat e rezidentëve të përfituara nga investimet e tyre të jorezidentët dhe të ardhura të pagueshme jorezidentëve për detyrimet e tyre në Shqipëri.

Të ardhura nga investimi direkt përfshijnë të ardhurat nga kapitali (dividendë dhe të ardhura të tjera të shpërndara dhe fitimi i riinvestuar) dhe interesi i huave ndërkompani të investimeve direkte.

Dividendët janë të ardhura të shpërndara aksionerëve të kapitalit në ndërmarrje që kanë investime.

Tërheqjet nga të ardhurat e quasi- korporata (ndërmarrje jo të inkuorpuara që veprojnë si korporata, të tilla mund të jenë degët, bashkimet joint-venture ose trustet) janë shumatat që aksionerët e quasi-korporatave tërheqin nga fitimet e tyre për përdorim personal.

Fitimi i riinvestuar është pjesa e fitimit të investitorit direkt nga totali i fitimit të konsoliduar për një periudhë kohe, të ndërmarrjes së investimit direkt mbas zbritjes së dividendëve që duhet të paguhen



për periudhën (pavarësisht nëse janë dividendë nga fitimi i periudhave të mëparshme).

Interesi paraqitet në formën e të ardhurave nga investimi në instrumentet e borxhit si depozita, letra me vlerë të borxhit, hua dhe të ardhura të tjera të arkëtueshme/ të pagueshme, duke i vendosur këto mjete financiare në përdorim të një njësie tjetër institucionale.

Të ardhura nga investimet e portofolit përfshijnë të ardhura nga letrat me vlerë të kapitalit (në formën e dividendëve) dhe interesin nga letrat me vlerë të borxhit (në formën e interesit).

Të ardhura nga investimet në kapital (dividendë) janë fitimet e shpërndara aksionerëve që kanë investuar në kapitalin e kompanisë në formën e letrave me vlerë.

Të ardhurat mbi letrat me vlerë të borxhit (interesi) janë në formën e të ardhurave nga investimet që përfitohen nga zotëruesit e letrave me vlerë të borxhit afatshkurtër dhe afatgjatë, si duke i vendosur këto mjete financiare në përdorim të një njësie tjetër institucionale.

Të ardhura nga investime të tjera përfshijnë të ardhurat nga interesi i depozitave, huave dhe mjete të tjera, të ardhura nga mbajtësit e policave të sigurimit dhe skemat e pensionit.

Të ardhura nga mjetet e rezervës përfshijnë të ardhurat nga interesi i mjeteve të rezervës së bankës qendrore (Ar, SDR, depozita, letra me vlerë të borxhit dhe mjete të tjera).

Të ardhura parësore të tjera përfshijnë tatimin mbi prodhimin dhe importet dhe subvencionet dhe qira mbi burime natyrore.

Taksa mbi prodhimin dhe importin përfshijnë pagesat pa kundërvleftë që vendosen nga qeveritë ose institucionet e BE-së, mbi prodhimin dhe importin e mallrave dhe shërbimeve.

Subvencionet janë pagesa pa kundërvleftë të kryera nga qeveritë ose institucionet e BE-së për prodhuesit rezidentë.

Qira mbi burimet natyrore përfshijnë të ardhurat e përfituara nga dhënia me qira e burimeve natyrore një jorezidenti (toka, nxjerrja e mineraleve dhe nënprodukteve të naftës, peshkimi, pyjet, të drejtat e kullotjes).

Të ardhurat dytësore përfitohen nga rishpërndarja e të ardhurave. Këtu përfshihen transfertat korrente pa kundërvleftë ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve, që mund t'i korrespondojë zotërimit të një malli, shërbimi, mjeti financiar ose jo financiar nga një njësi institucionale në një tjetër njësi institucionale. Këtu përfshihen tatimi mbi të ardhurat dhe pronën dhe taksa të tjera, kontribute shoqërore, primet dhe dëmet e sigurimeve, bashkëpunimet ndërkombëtare ndërmjet qeverive dhe transfertat të tjera korrente duke përfshirë dhe transfertat personale (ndërmjet individëve).

Tatimet dhe kontributet e sigurimeve shoqërore përfshijnë tatimin mbi të ardhurat dhe pronën të përfituara nga qeveria e përgjithshme mbi jorezidentët. Gjithashtu, janë përfshirë edhe pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore të bëra nga individët dhe përfitimet e kontributeve të sigurimeve shoqërore të dhëna nga qeveria për individët.



Bashkëpunimi ndërkombëtar përfshin transfertat korrente në cash ose në natyrë ndërmjet qeverive të ndryshme ose ndërmjet qeverive me organizatat ndërkombëtare.

Transferta korrente të ndryshme përfshijnë transfertat të ndryshme në cash ose në natyrë si gjoha, penalitete, fonde për lojërat e fatit dhe pagesa për kompensim. Transferta korrente të sektorëve të tjerë përfshijnë pagesa të kontratave të sigurimit, asistencën teknike të garantuar nga qeveria dhe transfertat personale duke përfshirë të ardhurat nga emigrantët.

Transfertat personale përfshijnë transfertat në cash ose në natyrë ndërmjet individëve rezidentë dhe jorezidentë. Gjithashtu, përfshihen edhe të ardhurat që dërgojnë emigrantët, të cilët konsiderohen jorezidentë për ekonominë pritëse meqenëse jetojnë dhe punojnë në një ekonomi tjetër për më shumë se një vit. Punonjës të huaj që jetojnë dhe punojnë në një vend për më pak se një vit konsiderohen si jorezidentë të atij vendi dhe pagat e tyre do të regjistrohen si të ardhura nga puna në llogarinë e të ardhurave parësore.

Llogaria kapitale përfshin transfertat kapitale, domethënë transaksione që përfshijnë transfertat e pronësisë mbi mjetet fikse ose eliminimin e detyrimeve nga kreditorët, pa marrë asgjë në këmbim (falje borxhi, grante investimi etj.) si dhe blerjet dhe shitjet e mjeteve jo prodhuese, jofinanciare.

Aktivet joprodhuese jofinanciare janë aktive ekonomike që ekzistojnë pavarësisht procesit të prodhimit. Të tilla aktive janë burimet natyrore, kontratat e tregtueshme, licencat, qiradhënia, e drejta tregtare dhe marka.

Transfertat kapitale përfshijnë taksat e kapitalit, grantet e investimeve dhe transfertat të tjera si për shembull falja e borxheve.

Huadhënia(+)/huamarrja neto(-) përfaqëson një zë balancues dhe tregon diferencën ndërmjet transaksioneve në mjete financiare me detyrimet financiare, për një periudhë të caktuar. Një vlerë pozitive e huadhënies tregon që ai sektor i caktuar ka financuar aktivitetet e sektorëve të tjerë. Nëse vlera është negative, më shumë fonde kanë ardhur nga sektorët e tjerë. Huadhënia neto (+) dhe huamarrja neto (-) për ekonominë tregon nëse një vend ka investuar jashtë apo ka marrë burime nga jashtë.

Llogaria financiare prezanton transaksionet e mjeteve dhe detyrimeve financiare.

Investimi direkt mbulon transaksionet e investitorëve rezidentë të një ekonomie për të siguruar, rritur ose disponuar një interes të qëndrueshëm në një ndërmarrje rezidente në një ekonomi tjetër dhe për të mbajtur ose për të pasur një shkallë të caktuar influence në menaxhimin e një ndërmarrjeje. Ai nuk mbulon vetëm investimin në kapital, por gjithashtu dhe huanë ndërkompani (duke përfshirë borxhin ndërmjet ndërmjetësve financiarë).

Kapitali përfaqëson kapitalin dhe aksionet, kapitalin e paguar të degëve, fitimin e riinvestuar dhe rezervat.

Fitimi i riinvestuar janë pjesa e pashpërndarë e të ardhurave operative, pas aplikimit të tatimit nga filialet, si dhe interesat neto të kapitalit që i atribuohen investitorit të drejtpërdrejtë. Këto të ardhura i alokohen rezervave të krijuara nga kompanitë.



Hua ndërkompani (investime direkte) mbulon pretendimet dhe detyrimet ndërmjet kompanive brenda një grupi të investimit direkt, siç janë kreditë tregtare, huatë dhe titujt e borxhit, të palidhura me kapitalin.

Një investitor direkt është një rezident i një ekonomie tjetër që zotëron të paktën 10% ose më shumë të aksioneve të zakonshme ose votuese në një kompani të investimit direkt.

Një kompani e investimit direkt është një kompani në të cilën 10% ose më shumë e aksioneve të zakonshme ose votuese (ose ekuivalenti) zotërohet nga një investitor direkt.

Ndërmarrjet e lidhura janë ndërmarrjet nën kontrollin ose influencën e të njëjtit investitor të menjëhershëm ose indirekt që nuk kontrollojnë ose influencojnë njëri-tjetrin.

Investimi në portofol reflekton të gjitha transaksionet në letra me vlerë të negociueshme ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve, duke përfshirë blerjet dhe emetimet e reja, tregtimin dhe pagesat, përveç transaksioneve të përfshira në investimet direkte, mjetet e rezervës ose derivativët financiarë.

Titujt në kapital janë ata që tregojnë të drejtën e zotëruesit të tyre në një pjesë të mjeteve të kompanisë dhe që u siguron zotëruesve të tyre të drejtën për të marrë pjesë në mbledhje të përgjithshme të aksionerëve dhe në shpërndarjen e fitimeve ose të aktiveve të mbetura pas shpërbërjes së kompanisë, dhe të drejta të tjera të siguruara nga ligji dhe nenet e lidhura. Ato ndahen në aksione të listuara, aksione të palistuara ose kapital tjetër.


Aksionet dhe njësitë në fondet e investimit janë tituj të regjistruar që tregojnë të drejtën e zotëruesit të njësisë të një pjese proporcionale në mjetet e fondit. Kjo nuk përfshin njësitë në fondet e pensionit.

Titujt e borxhit janë instrumente të tregtueshme që tregojnë një borxh dhe e identifikojnë atë nga data e emetimit, çmimi i emetimit, data e maturimit, çmimi i riblerjes ose vlera nominale, norma e kuponit, datat e pagesës së kuponit dhe të tjera të ngjashme. Titujt e borxhit vendosin detyrimin e emetuesit që të paguajë borxhin tek zotëruesi i titullit në një datë të rënë dakord si dhe interes për të. Titujt e borxhit përfshijnë obligacione, instrumente të tregut të parasë, fatura këmbimi, certifikata depozite të tregtueshme dhe letra tregtare. Titujt e borxhit ndahen në afatgjatë dhe afatshkurtër. Titujt e borxhit afatgjatë kanë një maturitet fillestar më shumë se një vit, dhe titujt e borxhit afatshkurtër kanë një maturitet fillestar një vit ose më pak se një vit.

Derivativët financiarë janë instrumente financiare që lidhen me një tjetër instrument financiar specifik, tregues ose mall (instrumenti kryesor) dhe nëpërmjet të cilit rreziqet financiare si rreziku i normës së interesit, rreziku i kapitalit ose çmimit të mallrave, rreziku i kreditit etj. mund të tregtohen në tregjet financiare. Derivativët kryesorë janë opsionet, kontratat "forward", "futures" dhe marrëveshjet e shkëmbimit swap.

Opsionet e aksioneve të punonjësve janë opsione për të blerë kapitalin e një kompanie të ofruar punonjësve të kompanisë si një formë shpërblimi. N.q.s. një opsion kapitali dhënë punonjësve mund të tregtohet në tregjet financiare pa kufizime, klasifikohet si derivativ financiar.

Investime të tjera të llogarisë financiare përfshijnë të gjitha transaksionet në mjete dhe detyrime financiare me jorezidentët që nuk kanë të bëjnë me investimet direkte, investimet e portofolit, derivativët



financiarë ose mjetet e rezervës. Në praktikë, kjo ka të bëjë kryesisht me depozitat bankare dhe kreditimin ndërbankar, si dhe me huatë dhe depozitat e kryera nga kompanitë e sigurimeve dhe të gjitha llojet e kompanive të fondeve të investimeve.

Kapitali tjetër është kapitali jo në formë titujsh, si pjesëmarrja në kapitalin e organizatave ndërkombëtare.

Monedhat janë kartëmonedhat dhe monedhat metalike në qarkullim të përdorura si mjet ligjor dhe të emetuara ose të autorizuara nga një bankë qendrore kombëtare.

Një depozitë është një detyrim financiar nga menaxheri i llogarisë tek zotëruesi i llogarisë, që lind nga kontrata ose marrëveshja midis menaxherit të llogarisë dhe zotëruetit të llogarisë. Depozitat gjithashtu përfshijnë njohje të regjistruar të detyrimit (certifikatat e depozitës) të emetuara nga depozita n.q.s. nuk është e transferueshme.


Huatë janë pretendime monetare që lindin nga një kontratë huaje ndërmjet një huadhënësi dhe një huamarrësi me një datë fikse pagese dhe në të cilën interesi i paguhet huadhënësit. Qiratë e kapitalit, kontratat e faktoringut dhe marrëveshjet e riblerjes klasifikohen gjithashtu si hua. Huatë afatshkurtra në mjete dhe detyrime ndërmjet institucioneve financiare regjistrohen si depozita. Huatë mund të jenë afatgjata ose afatshkurtra. Huatë afatgjata kanë një datë të përcaktuar shlyerjeje më shumë se një vit, dhe huatë afatshkurtra kanë një datë shlyerjeje brenda një viti, ku përfshihen dhe huatë e shlyera me kërkesë.

Skemat e sigurimit, pensione dhe skemat standarde të garancive përfshijnë rezervat teknike të sigurimit të jojetës, sigurimin e jetës dhe të drejtat vjetore, të drejtat e pensioneve, pretendimet e fondeve të pensioneve mbi menaxherët e pensioneve, të drejtat mbi përfitimet jo të pensioneve (e drejta për të marrë përfitime që nuk janë përfitime pensionesh) dhe provizionet dhe opsionet e garancive të standardizuara.

Kreditë dhe paradhëniet tregtare janë stoqe ose sasi të papaguara të të mirave dhe shërbimeve të shitura ose të blera dhe parapagesa, të regjistruara sipas kontabilitetit rrjedhës. Kreditë tregtare dhe paradhëniet lindin kur pagesa për mallrat ose shërbimet nuk bëhet në të njëjtën kohë kur ndryshon pronësia e një malli ose kur sigurohet një shërbim.

Llogari të tjera të arkëtueshme/ të pagueshme janë mjete dhe detyrime financiare që rezultojnë nga kontabiliteti rrjedhës dhe nga diferencat kohore ndërmjet transaksioneve dhe pagesave, dhe mjeteve dhe detyrimeve të tjera të palidhura me zëra të tjerë.

SDR-të janë njësi llogaritjeje të krijuara nga Fondi Monetar Ndërkombëtar që u janë caktuar shteteve anëtare, me një vlerë bazuar në kurset e peshuara të këmbimit të një shporte prej pesë monedhash: USD, EUR, JPY, GBP dhe CNY. Një SDR gjenerohet për çdo vend anëtar të FMN-së për realizimin e transaksioneve të huave dhe operacione të tjera të lidhura ndërmjet vendeve anëtare dhe FMN-së. Mjetet e rezervës janë mjete të ngjashme tepër likuide të bankës qendrore të vlefshme menjëherë për plotësimin e nevojave financiare të bilancit të pagesave, për menaxhimin e kurseve të këmbimit të monedhës nëpërmjet operacioneve të tregut dhe për qëllime të tjera të lidhura si ruajtja e besueshmërisë së monedhës.



Mospërputhja statistikore, që është diferenca ndërmjet shumës neto të llogarisë financiare dhe shumës neto të llogarisë korrente dhe kapitale, tregon se si llogaritë e bilancit të pagesave koordinohen. Idealisht bilanci i pagesave duhet të jetë i balancuar, që do të thotë që net-i i llogarisë korrente dhe kapitale duhet të jenë të barabartë me net-in e llogarisë financiare. Mospërputhjet statistikore lindin sepse në praktikë nuk është e mundur ose e arsyeshme të mbledhësh të gjitha transaksionet me ekonominë e jashtme, dhe në këtë mënyrë metoda të thjeshtëzuara dhe modele përdoren për kompilimin e statistikave.

Borxhi i jashtëm bruto është totali i të gjitha detyrimeve të borxhit të jashtëm të të gjithë sektorëve institucionalë të një vendi në pozicionin e investimeve ndërkombëtare, që janë borxh nga natyra e tyre dhe duhet të ripaguhen.

Borxhi i jashtëm neto është diferenca ndërmjet gjithë detyrimeve të jashtme të ripagueshme nga të gjithë sektorët institucionalë të një vendi dhe gjithë mjeteve të jashtme, të cilat janë borxh nga natyra e tyre.

Pozicioni i investimeve ndërkombëtare është një bilanc i konsoliduar i mjeteve dhe detyrimeve të jashtme i të gjithë sektorëve institucionalë të një vendi në një datë të caktuar në përfundim të tremujorit. Vlera neto e pozicionit të investimeve ndërkombëtare (PIN) llogaritet si diferenca e mjeteve të jashtme me detyrimet e jashtme të të gjithë sektorëve institucionalë të një vendi. Vlera neto e PIN është pozitive kur pretendimet e jashtme kalojnë detyrimet e jashtme. Vlera neto e PIN është negative kur detyrimet e jashtme kalojnë mjetet e jashtme.

IV. REZERVA NDËRKOMBËTARE

Rezerva ndërkombëtare konsiston në mjetet e huaja të rezervës zyrtare dhe mjete të tjera të huaja. Statistikat e rezervës ndërkombëtare dhe likuiditetit në valutë të huaj reflektojnë flukse neto afatshkurtra të paracaktuara dhe të kushtëzuara mbi mjetet në valutë të huaj dhe tregues të tjerë të mjeteve në valutë të huaj.

Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) është një institucion ndërkombëtar i kooperimit të politikës ekonomike, fushat kryesore të aktivitetit të të cilit përfshijnë mbikëqyrjen e politikës ekonomike, asistencën financiare dhe asistencën teknike.

Valuta e huaj është njësia ligjore e emtuar nga vendet jashtë Shqipërisë.

Valuta e huaj e konvertueshme është valuta që mund të konvertohet lirisht në monedha të tjera.

Titujt janë të drejta materiale, detyrime ose kontrata që mund të transferohen me një deklaratë qëllimi, të paktën nga njëra palë.

Një marrëveshje riblerjeje është një transaksion ku titujt shiten me një detyrim për t'i riblerë ata, ose titujt të ngjashëm, mbrapsht me një çmim fiks në një kohë të përcaktuar.

Pozicioni i rezervës në FMN konsiston në:

- Transhin e rezervës, që është kuota e paguar në FMN që një shtet anëtar mund të tërheqë nga FMN-ja me një njoftim të shkurtër. Për të përdorur transhin e tij në FMN, një shtet anëtar



mund të blejë valutë të huaj nga FMN-ja me monedhën e tij, vetëm nëse ka një nevojë të bilancit të pagesave. Rritja e transhit të rezervës është shitja nga FMN-ja e valutës së vendit anëtar për të plotësuar nevojën për përdorimin e burimeve të FMN-së nga vendet e tjera në nevojë të financimit të bilancit të pagesave;

- çdo borxh të FMN-së (nën një marrëveshje huaje) në llogarinë e Burimeve të Përgjithshme, që janë lehtësisht të disponueshme për vendin anëtar, përfshirë dhe huadhënien e atij vendi në FMN nën marrëveshjet e përgjithshme të huamarrjes dhe marrëveshjet e reja të huamarrjes.

Një marrëveshje e shkëmbimit të arit është një marrëveshje riblerjeje ku ari shkëmbehet me depozita në valutë me kushtin që transaksioni do të anulohet në një datë të caktuar në të ardhmen me një çmim të caktuar të arit. Marrësi i arit (siguruesi i cash-it) zakonisht nuk do ta regjistrojë arin në bilanc, ndërkohë që siguruesi i arit (marrësi i cash-it) zakonisht nuk do ta largojë arin nga bilanci i tij. Marrëveshjet e shkëmbimit të arit janë të ngjashme me marrëveshjet e riblerjes me përjashtim të faktit që në këtë rast kolaterali është ar.

Shufrat e arit janë ar në formë monedhe, shufre ose kallëpi, duke përfshirë shufrat e arit të mbajtura në llogaritë e alokueshme në ar.

Llogaritë e paalokueshme në ar përfaqësojnë një pretendim ndaj operatorit të llogarisë për të shpërndarë ar. Për këto llogari, pretendimet e zotëruesve të llogarisë mbulohen nga rezervat në ar të ofruesit të llogarisë.

Mjetet e tjera të rezervës janë mjete të tjera likuide, që përfshijnë derivativë financiarë dhe hua.

Mjetet e tjera në valutë të huaj janë pretendimet e bankës qendrore mbi rezidentët e tjerë të nominuara në valutë të huaj dhe pretendimet e qeverisë qendrore në valutë të huaj.

Një marrëveshje e monedhës është një kontratë nën të cilën pagesat e lindura nga mjeti në monedhën bazë shkëmbehen/ kryhen.


Pozicionet e shkurtra janë pozicione të derivativëve financiarë ku fitimi realizohet nga një rënie në çmimin e mjetit bazë, dhe një humbje realizohet nga një rritje në çmim. Kjo çon në një fluks dalës të monedhës së huaj.

Pozicionet e gjata janë pozicione të derivativëve financiarë ku fitimi realizohet nga një rritje në çmimin e mjetit bazë dhe një humbje realizohet nga një rënie në çmim. Kjo çon në një fluks hyrës të monedhës së huaj.

Një marrëveshje e kundërt riblerjeje, është një transaksion ku titujt blihen me detyrimin për t'i rishitur ata, ose tituj të tjerë të ngjashëm me një çmim fiks në një kohë të rënë dakord.

Detyrimet e kushtëzuara janë marrëveshje kontraktuale financiare që nuk lindin kërkesa të pakushtëzuara për të bërë pagesa në monedhë të huaj. Ato nuk njihen si mjete ose detyrime financiare para se kushtet kontraktuale të përmbushen.

Garancitë janë detyrime jashtë bilancit që përfaqësojnë një detyrim për të paguar një borxh n.q.s. debitori vetë dështon për ta paguar.



Linjat e kredisë janë një mekanizëm i kushtëzuar që përfaqësojnë burime potenciale për vendet që të marrin mjete shtesë në valutë të huaj.

Një opion është një derivativ financiar që i jep zotëruesit të drejtën për të blerë nga nënshkruesi ose të shesë tek nënshkruesi një mjet bazë me një çmim të paracaktuar në një datë të vendosur.

Borxhi i indeksuar me kursin e këmbimit është një borxh në të cilin madhësia e pagesave të interesit varet nga kursi i këmbimit.

Një mjet i vënë peng vendoset në rastet kur personi, i cili përfiton pengun ka të drejtë të plotësojë pretendimin e siguruar nga pengu jashtë pronës së pengut, n.q.s. pretendimi nuk është përmbushur plotësisht.

Një kontratë "forward" është një detyrim për të blerë ose shitur një mjet në një kohë specifike në të ardhmen me një çmim fiks.

Një kontratë "future" është një "forward" me kushte standarde që mund të tregtohet në bursë.

Një marrëveshje shkëmbimi (swap) është një kontratë ku palët shkëmbejnë pagesa të lindura nga mjetet bazë të transaksionit nën kushte specifike të mëparshme.

Shporta e SDR-së bazohet në një shportë prej pesë monedhash (USD, EUR, JPY, GBP dhe CNY) që përdoret si vlera bazë e SDR-së. Ari dhe pretendimet e nominuara në SDR regjistrohen në shportën SDR me këto monedha.

V. STATISTIKAT E UDHËTIMEVE NDËRKOMBËTARE

Udhëtime ndërkombëtare janë vizitat e një rezidenti të një vendi në një vend tjetër, në më pak se një vit dhe qëllimi i vizitës është jo për aktivitete fitimprurëse ose studime afatgjata.

Një vizitë me qëndrim mbi një natë është një vizitë gjatë së cilës udhëtari qëndron të paktën një natë në vendin e huaj.

Një vizitë ditore është një vizitë ku udhëtari hyn dhe largohet nga vendi i huaj brenda të njëjtës ditë, me një qëndrim prej disa orësh.

Numri total i vizitave përfaqëson numrin në total të vizitave ditore dhe atyre mbi një natë.

Kohëzgjatja në total e vizitave është totali i qëndrimit të udhëtimeve mbi një natë dhe udhëtimeve ditore.

